# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8285
E mërkurë, 22 prill 2026
Çmimi 0. 50 €


## Vrasja e Liridona Ademajt: Murseli dhe Plava dënohen me burgim të përjetshëm, Kokalla me 30 vjet

FAQE 7




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


# KURTI: OFERTA JONË ËSHTË SHUMË GJENEROZE, POR OPOZITA S'ËSHTË E INTERESUAR TA ZHBLLOKOJË PROCESIN

FAQE 4-5



Kryeministri i vendit, njëherësh kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka thënë të martën se oferta që ai ua ka bërë dy partive opozitare, PDK-së dhe LDK-së, në këmbim të zgjedhjes së presidentit të ri, është "shumë gjeneroze". Ai ka theksuar se partitë politike duhet të sillen në përputhje me rezultatin e zgjedhjeve parlamentare të 28 dhjetorit 2025, kur partia e tij fitoi 51.1 për qind të votave



## PARTITË PA UJDI PËR PRESIDENTIN, KOSOVA DREJT ZGJEDHJEVE TË REJA

F. 4



## OPOZITA DHE QEVERIA PËRPLASEN PËR GJENDJEN NË SEKTORIN E ENERGJISË

F. 3

## AKTUALE




### KOS THOTË SE KA ZHVILLIME "INKURAJUESE" LIDHUR ME PESË SHTETET QË S'E NJOHIN KOSOVËN

F. 2

### KOSOVA I SHPREH MIRËNJOHJE AJOVËS PËR AVANCIMIN E KAPACITETEVE TË FSK-së

F. 6

### KONSULLATA E PËRGJITHSHME E KOSOVËS NË NJU-JORK NDERON JETËN DHE VEPRËN E KONGRESISTIT ELIOT ENGEL

F. 3

## EKONOMI



### SHAHINI: FMN GODET FORT, KOSOVA EDHE NË 2030 NDËR VENDET MË TË VARFRA NË EVROPË

F. 8

### ZRRE SIGURON KONSUMATORËT: DO TË PARANDALOHEN DËMET NË FATURIMIN E RRYMËS

F. 8

## SPORT



### DRITA SHPALLET KAMPIONE DHE SIGURON RIKTHIMIN NË SUPERLIGË

F. 11


RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht -Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

## Rregulla të reja të BE-së, nga 2027 ndryshon përbërja, bateritë bëhen të zëvendësueshme

**Bruksel, 21 prill** - Duke nisur nga viti 2027, çdo celular që do të shitet në tregun evropian duhet të përmbushë standarde më të forta për jetëgjatësinë, performancën dhe riparueshmërinë.
Një nga ndryshimet më të rëndësishme lidhet me baterinë. Në shumë raste ajo do të duhet të jetë e zëvendësueshme më lehtë nga vetë përdoruesit, duke i dhënë fund praktikës së telefonave të mbyllur që kërkojnë ndërhyrje të kushtueshme për një problem të thjeshtë. Kjo do të thotë se përdoruesit nuk do të detyrohen më të blejnë një pajisje të re vetëm sepse bateria nuk mban më karikim.
Sipas rregullave të reja, bateritë duhet ta ruajnë performancën më gjatë edhe pas shumë cikleve karikimi, ndërsa vetë pajisjet duhet të projektohen në mënyrë që të riparohen më lehtë. Aktualisht shumë telefona kërkojnë mjete speciale apo shërbime profesionale për t'u hapur, gjë që rrit kostot për konsumatorët.
Ndikimi i këtyre rregullave pritet të shkojë përtej Evropës, pasi kompanitë e mëdha nuk pëlqejnë të prodhojnë versione të ndryshme për çdo treg. Kjo do të thotë se ndryshimet mund të reflektohen edhe në modelet globale të iPhone dhe Android. Për përdoruesit, përfitimi është i dyfishtë: më pak shpenzime dhe më shumë jetë për pajisjet. Ndërsa për mjedisin, më pak mbetje elektronike dhe një përdorim më i qëndrueshëm i burimeve. Në thelb, Evropa synon t'i japë fund kulturës së zëvendësimit të shpejtë dhe ta nxisë riparimin si zgjedhje e parë.



# KOS THOTË SE KA ZHVILLIME "INKURAJUESE" LIDHUR ME PESË SHTETET QË S'E NJOHIN KOSOVËN

**Prishtinë, 21 prill** - Komisionarja për Zgjerim e Bashkimit Evropian, Marta Kos, i cilësoi "inkurajuese" zhvillimet rreth pesë vendeve evropiane që nuk e njohin pavarësinë e Kosovës.
Gjatë një mbledhjeje të jashtëzakonshme të Komitetit për Punë të Jashtme të Parlamentit Evropian, raportuesi për Kosovën në PE, Riho Terras, e pyeti komisionaren Kos se çfarë po bën Komisioni Evropian sa iu përket pesë shteteve mosnjohëse, kur ka diskutuar së fundi me ta dhe si duhet vepruar në këtë drejtim. "Sa iu



përket pesë shteteve mosnjohëse, unë ndjek çfarë po ndodh dhe zhvillimi është inkurajues", tha shkurt Kos.
Greqia, Spanja, Rumania, Sllovakia dhe Qiproja, shtete anëtare të BE-së, nuk e njohin pavarësinë që Kosova shpalli më 2008.
Mospranimi nga këto shtete vlerësohet si pengesë për rrugën evropiane të Kosovës.
Kosova ka dorëzuar aplikimin për anëtarësim në BE në dhjetor të vitit 2022. Megjithatë ky aplikim ende nuk ka kaluar as në fazën e parë formale, atë të shqyrtimit nga Këshilli i BE-së dhe më pas dërgimit për opinion në Komisionin Evropian.
Gjatë mbledhjes Terras e pyeti Kosin se pse nuk e ka vizituar Kosovën ende që kur ka marrë mandatin. Komisionarja evropiane tha se, pavarësisht se nuk ka qenë në Kosovë, ajo është në kontakt me autoritetet në Prishtinë. Ajo theksoi se për shkak të situatës politike, është detyruar ta shtyjë një vizitë në Kosovë. Megjithatë, Kos në fjalën hyrëse në seancë tha se pret që së shpejti të qëndrojë në Kosovë për reformat që e lidhin me Planin e Rritjes. "Kemi hequr masat dhe presim që qeveria t'i vazhdojë reformat e nevojshme për të përfituar nga mbështetja e BE-së. Së shpejti do të qëndrojë në Prishtinë për ta çuar përpara këtë çështje", tha ajo.
Më 16 prill Kosova mori 61.8 milionë euro parafinancim, pasi vendi dorëzoi dokumentet e nevojshme në KE dhe ratifikoi marrëveshjet e lidhura me këtë plan.
Pakoja e BE-së për Ballkanin Perëndimor - për periudhën 2024-2027 - është në vlerë të 6 miliardë eurove. Nëse analizohen ndarjet buxhetore, Kosovës i takojnë rreth 882 milionë euro - 253 milionë si grante dhe 629 milionë euro në formë të kredisë - që do të thotë se përfiton më së shumti fonde në rajon për kokë banori.

# KRIZA E NAFTËS, GJERMANIA MBLEDH KËSHILLIN E SIGURISË KOMBËTARE: GATI TË NDËRHYJMË

**Berlin, 21 prill** - Situata e naftës në Gjermani është kaq delikate dhe strategjike, sa kancelari Friedrich Merz dëshiron ta mbledhë "së shpejti" Këshillin e Sigurisë Kombëtare për konsultime mbi krizën energjetike.
Lajmin e dha ai, por nuk dha hollësi të tjera. "Qëllimi ynë është i qartë: ekonomia gjermane dhe qytetarët duhet të jenë të sigurt se furnizimi me produkte të domosdoshme, siç janë nafta, benzina dhe karburanti për avionë, do të mbetet i garantuar", deklaroi Merz më herët në Hannover.
Aktualisht gjendja paraqitet e "tensionuar", por furnizimi është i siguruar. Në rast se situata përkeqësohet, atëherë ne jemi të gatshëm të ndërhyjmë, citohet të ketë thënë ai. Çmimet e karburantit për avionët në Evropë janë më shumë se dyfishuar që nga momenti kur ShBA-ja dhe Izraeli nisën luftën kundër Iranit më 28 shkurt.
Teherani reagoi duke bllokuar shumicën e transportit detar në Gjirin e Hormuzit, nga



kalon një e pesta e naftës globale. Që prej marrjes së detyrës, Merz e kishte kërkuar vetëm një herë mbledhjen e Këshillit në fjalë, në muajin nëntor për të miratuar një plan veprimi kundër kërcënimeve hibride, kryesisht nga Rusia. "Për ne është e qartë: siguria e furnizimeve ka prioritet maksimal për Gjermaninë", deklaroi ai, teksa theksoi se për ta garantuar stabilitetin do të përdoren "të gjitha mjetet e disponueshme".
Çmimi i karburantit është rritur ndjeshëm në Gjermani si edhe në vende të tjera, duke e detyruar qeverinë të ndërhyjë, e për momentin po diskutohet mundësia e uljes së akcizave.

## Trumpi këmbëngul se Irani do të negociojë përpara bisedimeve në Pakistan

Uashington, 21 prill - Presidenti i ShBA-së, Donald Trump, këmbëngulі se Irani "do të negociojë" përpara bisedimeve të pritura në Pakistan. Duke folur në një intervistë të shkurtër telefonike në "The John Fredericks Show", një program radiofonik konservator, Trumpi shprehu besimin se Teherani do të ulej në tryezën e bisedimeve, ndërsa paralajmëroi për pasoja nëse nuk e bën këtë. "Epo, ata do të negociojnë, dhe nëse nuk e bëjnë këtë, do të shohin probleme që nuk i kanë parë kurrë më parë", tha presidenti. "Shpresojmë që ata do të bëjnë një marrëveshje të drejtë dhe do ta rindërtojnë vendin e tyre", vazhdoi Trumpi, duke shtuar se kur ta bëjnë këtë, "ata nuk do të kenë armë bërthamore".
Përpara se ta mbyllte telefonatën, Trumpi iu rikthye justifikimit të tij për veprim



ushtarak. "Dhe duhet të them se nuk kishim zgjidhje tjetër në Iran", tha ai. "Nuk ishte sikur kishim zgjidhje tjetër. Na duhej ta bënim. Kemi bërë një punë të shkëlqyer dhe do ta përfundojmë, dhe të gjithë do të jenë të lumtur", shtoi ai para se ta mbyllte telefonin.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# OPOZITA DHE QEVERIA PËRPLASEN PËR GJENDJEN NË SEKTORIN E ENERGJISË

Prishtinë, 21 prill - Ligjvënësit në Kosovë kanë debatuar të martën për gjendjen në sektorin e energjisë në vend, në një seancë të jashtëzakonshme të thirrur nga 42 deputetë të martën, mes shqetësimeve për çmimin e lartë të rrymës, mungesën e prodhimit dhe dyshimeve për manipulime me faturim.
Deputetë opozitarë e akuzuan qeverinë e kryeministrit Albin Kurti për, siç thanë, gjendjen e rënduar në sektorin e energjisë, akuza që u hodhën poshtë nga ministrat e Kurtit.
Deputeti Ferat Shala nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në opozitë e paraqiti çështjen para ligjvënësve, duke thënë se "qytetarët po paguajnë taksë jomeritore dhe sektori i energjisë është në situatë jashtëzakonisht të rënduar". "Që gjashtë vjet qeveria e ka menaxhuar këtë sektor me të njëjtën logjikë, me të njëjtën politikë qeverisëse e cila është treguar, e shifrat tregojnë tashmë që është e dështuar", theksoi Shala, duke përmendur që shteti nuk ka rritje të kapaciteteve prodhuese që plotësojnë kërkesat për rrymë.
KEK - korporata shtetërore dhe prodhuesi mbizotërues i rrymës në vend - mund t'i prodhojë deri në 800 megavate në orë, kurse nevojat e vendit, në një ditë dimri, për shembull, arrijnë deri në 1 300 megavate në orë. Prandaj, vendi detyrohet të importojë rrymë nga jashtë për t'i mbuluar nevojat e konsumatorëve.
Të dhënat e Doganës së Kosovës tregojnë se vendi kishte importuar rrymë në vlerë të rreth 248 milionë eurove në periudhën janar-nëntor 2025, ndërsa kishte eksportuar në vlerë të rreth 48 milionë eurove.
Ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, tha se prodhimi i rrymës në vend do të jetë më i lartë vitin e ardhshëm për shkak të investimeve në dy termocentralet e vjetruara, Kosova A dhe Kosova B.
Konsumatorët që shpenzojnë deri në 800 kilovatë në orë në muaj paguajnë 9.05 centë për kilovat, ndërsa ata që shpenzojnë mbi këtë prag paguajnë 15.43 centë për kilovat. Kurse tarifat e lira që shfrytëzohen gjatë natës nga ora 23:00 deri në 08:00 të mëngjesit, konsumatorët për një kilovat paguajnë 3.88 centë për ata që shpenzojnë deri në 800 kilovatë. Ndërkaq, ata që shpenzojnë më shumë se 800 kilovatë paguajnë 7.28 centë për kilovat.
Derisa ka pasur vazhdimisht rritje të çmimit të tarifave në vitet paraprake, rregullatori i energjisë, ZRRE, ka propozuar që të mos ketë rritje të tarifave të energjisë elektrike për këtë vit.
Rizvanolli tha se çmimi i energjisë elektrike mbetet më i ulëti në rajon dhe e akuzoi opozitën për "shpifje". "Ndër gënjeshtrat më të mëdha që është thënë këto vite e këta muaj, se importi ka qenë 250 euro vitin e kaluar. Ju e keni lexuar shifrën, por jo edhe fusnotën, e cila tregon që aty përfshihet edhe energjia që kalon tranzit nëpër Kosovë. Këtë gënjeshtër e thoni vazhdimisht", tha ajo.
Sipas saj, 176 milionë euro ishte importi në vitin 2025.
Deputetja e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Janina Ymeri, tha se qytetarët po e bartin barrën e rritjes së çmimit të rrymës për shkak të "keqmenaxhimit nga qeveria". "[Faji] ka qenë te keqmenaxhimi i komplet sektorit elektroenergjetik, duke filluar nga prodhimi e deri tek inkriminimi i ZRRE-së. Thuhet se ZRRE-ja i përgjigjet Kuvendit, por ajo nuk më përgjigjet mua në pyetjen më të thjeshtë për mafinë energjetike. Ky pushtet e ka gllabëruar plotësisht sektorin e energjisë elektrike", tha Ymeri.
"Si mund të jetë ky sektor i pavarur kur në zyrën ku bëhet edhe tregtia e energjisë elektrik, aty ku është edhe bilanci, është edhe vetë vëllai i kryeministrit [Albin Kurti]", tha ajo duke iu referuar Taulant Kurtit.



Taulant Kurti është specialist për çështje ekonomike në Drejtorinë e Operimeve në KEK dhe, sipas korporatës, ai ka qenë pjesë e KEK-ut që nga viti 2007.
Ramush Haradinaj i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) në opozitë, e akuzoi kryeministrin Albin Kurti dhe, siç tha, "rrethin e afërm të tij" për anulim të projektit të termocentralit "Kosova e re". "Serbia nuk ka krijuar fitore më të madhe ndaj Kosovës, pas '99-s sesa këtë dështim të termocentralit të ri 500 megavat dhe pastaj dorëzimit të Kosovës te Serbia", tha Haradinaj.
Haradinaj shtoi se "mafia energjetike e Ballkanit që dominohet nga serbët dhe bashkë me njerëzit e afërt të Kurtit dhe Dejona Mihalit krijojnë kompani çdo dy javë", duke iu referuar koordinatores së komiteteve në Lëvizjen Vetëvendosje. "Në këto kompani është një i afërt i Kurtit, i Dejonës. Janë kujdesur të kontrollojnë të gjitha institucionet në energji", ka thënë ai duke shtuar se edhe në KEK e ZRRE "vetëm Kurti e Dejona vendosin se kush emërohet aty".
Haradinaj nuk dha prova për t'i mbështetur pretendimet e tij, ndërsa partia në pushtet i ka hedhur poshtë edhe në të kaluarën pretendimet e Haradinajt.
Kosova e kishte nënshkruar një marrëveshje komerciale me kompaninë amerikane Contour Global, për ndërtimin e termocentralit "Kosova e Re", një projekt në vlerë 1.3 miliard euro që parashihej të hynte në punë më 2023.
Projekti u kundërshtua nga shoqëria civile në Kosovë dhe zëra ndërkombëtarë për shkaqe mjedisore.
Më 2020 Contour Global u tërhoq nga projekti, duke përmendur se nuk synonte më projekte me thëngjill, si dhe për shkak të ndryshimit të udhëheqjes në Kosovë. Në pushtet, atë kohë, ishin Lëvizja Vetëvendosje dhe Lidhja Demokratike e Kosovës, të cilat kishin shprehur shqetësime për mundësinë e shtrenjtimit të çmimit të energjisë.

### Çështja e njehsorëve të rrymës

Debati vjen gjithashtu në një kohë kur autoritetet kanë gjetur se Kompania Kosovare për Distribuim të Energjisë Elektrike (KEDS) ka njehsorë elektrikë me afat të skaduar.
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit (MINTI), e gjobiti javën e kaluar KEDS-in me 30 000 euro për gjashtë njehsorë me afat të skaduar të vlefshmërisë.
Deputetja e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Hykmete Bajrami, tha se "po bëhen vjedhje klasike në blloktarifa" prej se qeveria Kurti i vendosi ato.
KEDS - shpërndarësi i vetëm i rrymës në vend - është urdhëruar nga MINTI t'i dëmshpërblejë konsumatorët e dëmtuar.
Shpërndarësi i rrymës i ka mohuar shkeljet, duke thënë se mospërputhjet janë çështje teknike dhe jo manipulim.
Ai ka thënë se nëse kalimi në tarifë është bërë me disa minuta vonesë, atëherë edhe ka përfunduar më vonë. Por, kompania tha se, në rast të gjetjes së pasaktësive jashtë normave të lejuara, "qytetarët do të kompensohen deri në centin e fundit".
Ndërkohë, në fillim të prillit, Prokuroria Themelore në Prishtinë e autorizoi policinë të kryejë hetime lidhur me dyshimet për parregullsi në njehsorët elektrikë të shpërndarësit të rrymës.

# KONSULLATA E PËRGJITHSHME E KOSOVËS NË NJU-JORK NDERON JETËN DHE VEPRËN E KONGRESISTIT ELIOT ENGEL



Prishtinë, 21 prill - Në një mbrëmje përkujtimore të organizuar nga Konsullata e Përgjithshme e Republikës së Kosovës në Nju-Jork dhe nga Harry Bajraktari, u nderua jeta dhe veprimtaria e kongresistit amerikan Eliot Engel, një prej mbështetësve më të fuqishëm të pavarësisë së Kosovës.
Në aktivitet morën pjesë bashkëshortja e tij, zonja Pat Engel, familjarë të afërt, përfshirë shefin e kabinetit të tij John Calvelli, si dhe rreth 70 bashkatdhetarë nga komuniteti shqiptar në ShBA.
Gjatë mbrëmjes u vlerësua roli i gjatë dhe i qëndrueshëm i kongresistit Engel në mbështetje të Kosovës për më shumë se tri dekada.
Shefi i Misionit në Konsullatën e Përgjithshme të Republikës së Kosovës në Nju-Jork, Blerim Reka, ka theksuar se për tri dekada Elliot Engell ishte zëri i Kosovës së pushtuar në Uashington. "Me bashkëshorten e kongresistit Eliot Engell, zonjën Pat Engell, në mbrëmjen komemorative të organizuar nga Konsullata e Përgjithshme e Republikës së Kosovës në Nju Jork dhe Harry Bajraktari. Nën praninë e familjes Engell, shefit të kabinetit të tij të John Calvelli dhe rreth 70 bashkëatdhetarëve tanë, mbrëmë në Nju-Jork nderuam jetën dhe veprën e mbështetësit të Pavarësisë së Kosovës dhe mikut të madh të shqiptarëve. Për tri dekada, Elliot Engell, ishte zëri i Kosovës së pushtuar në Uashington. Dhjetëra rezoluta për Kosovën në Dhomën e Përfaqësueseve në Senatin Amerikan, e shumë letra të dërguara presidentëve amerikan, kishin nismën dhe autorësinë e kongresistit Engell. Lavdi!", ka shkruar Reka në "Facebook".



# PARTITË PA UJDI PËR PRESIDENTIN, KOSOVA DREJT ZGJEDHJEVE TË REJA

Tri subjektet kryesore politike në Kosovë duket se janë larg arritjes së një marrëveshje për çështjen e presidentit. Afati kushtetues për zgjedhjen e presidentit skadon më 28 prill dhe nëse deri atëherë nuk zgjedhet një president, Kosova do të mbajë zgjedhje të reja. E teksa ky afat po shkon drejt fundit, njohës të zhvillimeve politike thonë se partia në pushtet nuk po dëshiron zgjidhje, ndërkaq ato opozitare nuk i dëshirojnë zgjedhjet, por as "t'i nënshtrohen" LV-së së Albin Kurtit

PRISHTINË, 21 PRILL - Tri subjektet kryesore politike në Kosovë duket se janë larg arritjes së një marrëveshje për çështjen e presidentit, duke bërë që vendi të shkojë drejt zgjedhjeve të reja. Kjo pasi Lëvizja Vetëvendosje në pushtet, dhe Lidhja Demokratike e Kosovës në opozitë, dështuan që të arrinin një marrëveshje të hënën, ndërkaq disa orë më vonë subjekti më i madh opozitar, Partia Demokratike e Kosovës, tha se e konsideron "të përmbyllur" kontributin e saj sa i përket çështjes së zgjedhjes së presidentit.

PDK-ja ka theksuar se të hënën ka pranuar një ofertë nga LV-ja për presidentin, por kreu i kësaj partie, Bedri Hamza, e vlerësoi "joserioze".

Afati kushtetues për zgjedhjen e presidentit skadon më 28 prill dhe nëse deri atëherë nuk zgjedhet një president, Kosova do të mbajë zgjedhje të reja. E teksa ky afat po shkon drejt fundit, njohës të zhvillimeve politike thonë se partia në pushtet nuk po dëshiron zgjidhje, ndërkaq ato opozitare nuk i dëshirojnë zgjedhjet, por as "t'i nënshtrohen" LV-së së Albin Kurtit.

Pas takimit të zhvilluar më herët gjatë ditës, udhëheqësi i LV-së, kryeministri Albin Kurti, tha për mediet se kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, nuk i pranoi ofertat e tij për një marrëveshje dhe tregoi se ai tashmë i ka shkruar liderit të partisë kryesore opozitare, Bedri Hamzës së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), për një takim të mundshëm.

"Më duhet të them se bisedimet ishin të pasuksesshme sepse asnjëra nga ofertat tona nuk u pranua nga kreu i LDK-së", tha Kurti duke paralajmëruar se vendi rrezikon të shkojë përsëri në zgjedhje të parakohshme, nëse presidenti i ri nuk zgjidhet deri më 28 prill.

Ai tha se ia ofroi LDK-së, në bashkëqeverisje me partnerët e tjerë, ta këtë zëvendëskryeministrin, Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe tri ministri të tjera.

Në një ofertë tjetër, Kurti tha se ia ofroi LDK-së postin e kryetarit të Kuvendit të Kosovës. "Unë kam preferuar që zëvendës imi të bëhet pikërisht Abdixhiku, dhe në këtë mënyrë të fillojmë kapitull të ri bashkëpunimi mes LDK-së dhe LV-së", theksoi Kurti.

Ndërkohë, Abdixhiku theksoi se nuk do të takohet më me Kurtin pas dështimit të bisedimeve. "U përpoqa, provova, nuk arrita, fatkeqësisht. Tani do t'i kthehem LDK-së dhe do t'i kthehem misionit të madh të bashkimit të së djathtës brenda LDK-së", ka thënë Abdixhiku pas takimit, duke përsëritur qëndrimin e partisë së tij, që një parti nuk mund t'i udhëheqë tre institucionet kryesore në vend: Kuvendin, Qeverinë dhe Presidencën. Sipas tij, kryeministri Kurti ka insistuar që pozita e presidentit t'i mbetej partisë së tij.

Kurti, në anën tjetër, nguli këmbë se nuk dëshiron që partia e tij t'i udhëheqë tri institucionet kryesore të vendit.

Ndërkohë, i pyetur nëse ka një përafrim mes LDK-së dhe ish-presidentes Vjosa Osmani, së cilës i skadoi mandati më 4 prill, Abdixhiku ka deklaruar se diçka e tillë do të ishte lajm i mirë edhe për Kosovën edhe për LDK-në. "Është qëllimi im dhe do të punoj për këtë qëllim deri në ditën e fundit".

### PDK-ja e konsideron "të përmbyllur" kontributin e saj për çështjen e presidentit

Pas mbledhjes së Këshillit Drejtues partiak, kreu i PDK-së, Bedri Hamza, tha për mediet se kreu i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, i ka dërguar një ofertë në WhatsApp, por shtoi se nuk ka pranuar ftesë zyrtare për takim. "Oferta është kjo, që deputetët e partisë e PDK-së të qëndrojnë në sallë, të votojnë dhe si rezultat i kësaj, PDK-së i ofrohet posti i kryetarit të Kuvendit me një lloj ndryshimi, që LVV-së t'i kalohet pozita e nënkryetarit të Kuvendit që aktualisht e ka PDK. E para kjo nuk është serioze, sepse kryesia e Kuvendit është e konstituuar", tha Hamza, duke shtuar se, përveç që, sipas tij, një ofertë e tillë nuk është serioze, nuk është "as kushtetuese".

Hamza tha se qëndrimi i tyre ka qenë që presidenti të propozohet nga PDK-ja, por jo dikush që domosdo do të ishte pjesë e strukturave partiake.

Kurti, pas takimit me Abdixhikun, deklaroi se i ka dërguar ftesë PDK-së për takim. Kur u pyet nëse do t'i bënte ndonjë ofertë të ngjashme edhe PDK-së, Kurti nuk deshi të tregojë, por shtoi se "oferta për bashkëqeverisje që u ofrua për LDK-në ka qenë ekskluzive për LDK-në".

Kurti e ka kritikuar PDK-në se në bisedimet e mëparshme kishte kërkuar që dikush nga partia opozitare të zgjidhej president pa treguar emrin e kandidatit të mundshëm. Ai e përsëriti këtë edhe të hënën, duke thënë: "PDK-ja ka kërkuar nga unë që të bëj marrëveshje politike blanko ku

# KURTI: OFERTA JONË ËSHTË SHUMË GJENEROZE, POR OPOZITA S'ËSHTË E INTERESUAR TA ZHBLLOKOJË PROCESIN




**Kryeministri i vendit, njëherësh kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka thënë të martën se oferta që ai ua ka bërë dy partive opozitare, PDK-së dhe LDK-së, në këmbim të zgjedhjes së presidentit të ri, është "shumë gjeneroze". Ai ka theksuar se partitë politike duhet të sillen në përputhje me rezultatin e zgjedhjeve parlamentare të 28 dhjetorit 2025, kur partia e tij fitoi 51.1 për qind të votave**

Prishtinë, 21 prill - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), njëherësh kryeministër i Kosovës, Albin Kurti, tha të martën se oferta që ai ua ka bërë dy partive opozitare, Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), në këmbim të zgjedhjes së presidentit të ri, është "shumë gjeneroze". Por, sipas tij, këto parti nuk janë të interesuara që ta zhbllokojnë procesin.

Një ditë më herët LV-ja dhe LDK-ja, pas një takimi të zhvilluar, nuk arritën një marrëveshje për çështjen e presidentit, teksa deputetët kanë kohë deri më 28 prill që ta zgjedhin presidentin e ri, në të kundërtën vendi shkon në zgjedhje.

Kurti i ofroi LDK-së pozitën e zëvendëskryeministrit, Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe tri ministri të tjera.

Ndërkaq, më vonë, gjatë 20 prillit, kreu i PDK-së, Bedri Hamza, njoftoi se Kurti, përmes një komunikimi në WhatsApp, i kishte ofruar postin e kryetarit të Kuvendit, por që PDK-ja t'ia japë LV-së postin e nënkryetarit të organit ligjvënës. Partia e Hamzës tha se ka përmbyllur kontributin e saj për çështjen e presidentit.

Kurti tha për mediet të martën se partitë duhet të sillen në përputhje me rezultatin e zgjedhjeve parlamentare të 28 dhjetorit 2025, kur partia e tij fitoi 51.1 për qind të votave. "Oferta jonë është shumë gjeneroze, por nuk janë të interesuar që ta zhbllokojnë. Po sillen thuajse është viti 2025, kur, e mbani mend me atë seancën kur nuk votohej Albulena Haxhiu. Ka kaluar viti 2025. Është viti 2026", tha ai.

Duke folur për ofertën që ia bëri PDK-së, që Hamza e cilësoi joserioze, Kurti tha se në atë rast, kryetarja e Kuvendit, Albulena Haxhiu, do t'ia lironte vendin Bedri Hamzës, duke e cilësuar si "koncesion të madh për ne", pasi theksoi se katër veta në LV kanë "më shumë vota sesa Bedri Hamza". "Përveç meje, Glauk Konjufca, Albulena Haxhiu edhe Hekuran Murati kanë më shumë vota sesa Bedri Hamza".

Ndërkaq, duke iu referuar LDK-së, Kurti tha se dhjetë persona në LV kanë më shumë vota sesa kreu i kësaj partie opozitare, Lumir Abdixhiku. "Unë nuk po them që opozita është e parëndësishme, përkundrazi, kam bërë ofertë gjeneroze. Kryetari i LDK-së mund të bëhet zëvendëskryeministër, zëvendësi im, dhe përveçse të jetë zëvendëskryeministër, njëkohësisht të jetë edhe ministër i Punëve të Jashtme, pra t'i kenë katër ministri edhe të jetë zëvendëskryeministër. Dhe, jo vetëm kaq, ose ta kete versionin tjetër, nëse nuk i pëlqen të bashkëqeverisë, ta bëjmë rokadën ku Lumir Abdixhiku ose dikush tjetër i LDK-së bëhet kryetar Kuvendi", tha Kurti.

ata i propozojnë dy kandidatët e ne ua votojmë".

Ndërkaq, PDK përmes një njoftimi tha se ka dëshmuar "gatishmëri" për të kontribuuar për zgjedhjen e një presidenti të ri, pasi ish-presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, i përfundoi mandati pesëvjeçar më 4 prill.

PDK tha se ka mbështetur mundësinë e një kandidati konsensual, "pa asnjë kushtëzim" apo përfshirje në bashkëqeverisje. "Megjithatë, përkundër kësaj qasjeje konstruktive, mungesa e vullnetit politik dhe seriozitetit institucional nga ana e pushtetit aktual po e pamundëson përsëri zgjedhjen e presidentit të ri. Rrjedhimisht, PDK e konsideron kontributin e saj në këtë proces të përmbyllur", u tha në njoftim.

Në mbledhjen e së hënës PDK miratoi një deklaratë politike, ku tha se vendi po përballet me kriza të njëpasnjëshme politike dhe institucionale "të shkaktuara drejtpërdrejt nga shumica parlamentare, e cila përmes bllokadave të vazhdueshme dhe mungesës së përgjegjësisë shtetërore po e paralizon funksionimin normal të institucioneve, po i politizon ato dhe po e dëmton interesin qytetar e shtetëror".

## Arifi: LV nuk po dëshiron zgjidhje

Për dështimin e bisedimeve LV-LDK për çështjen e presidentit, politologu Dritëro Arifi ia vë fajin partisë në pushtet. Sipas tij, problemeve duhet dhënë zgjidhje dhe drejtim. "Në këtë rast, sidomos partia në pushtet nuk po dëshiron drejtim të saktë, dëshiron një mënyrë që të viktimizohet, që kinse janë të tjerët që nuk po i lënë hapësirë që të punojë. Që një vit e gjysmë jemi pak a shumë në këtë krizë, ku partia e parë nuk po dëshiron zgjidhje, por në njëfarë mënyrë po dëshiron kapje dhe nënshtrim të çdo gjëje që ekziston në Kosovë", thotë ai për Radion Evropa e Lirë.

Sipas tij, një qasje e tillë i dëmton të gjithë, veçmas LV-në, duke paralajmëruar se partia e Kurtit mund ta humbasë besimin e qytetarëve "nëse vazhdon që të ankohet rregullisht, vazhdimisht dhe për çdo gjë".

I pyetur se a mendon se ka gjasa për një marrëveshje mes LV-së dhe PDK-së, Arifi shpreh skepticizëm, por thotë se gjërat mund të lëvizin në moment të fundit.

Ai thotë se opozita nuk i dëshiron zgjedhjet, por "as nënshtrim". "Mendoj që partitë opozitare edhe nuk po kanë dëshirë të shkojnë në zgjedhje, por nuk po duan që të nënshtrohen brutalisht. Në njëfarë forme nuk po shoh marrëveshje normale", thotë Arifi.

Sipas Kushtetutës, presidenti i Kosovës zgjidhet me dy të tretat e votave në dy raundet e para apo me 61 vota në raundin e tretë, por nevojiten 80 deputetë në sallë që seanca të mund të mbahet. Prandaj, nevojitet një marrëveshje mes partive parlamentare për këtë çështje, duke qenë se asnjëra parti - madje as ajo në pushtet e Kurtit, Lëvizja Vetëvendosje me 57 deputetë - nuk e ka një numër kaq të madh deputetësh në Kuvendin me 120 vende.

Pasi Vjosa Osmanit i mbaroi mandati në fillim të muajit dhe vendi nuk arriti ta emërojë zëvendësuesin e saj, kryetarja e Kuvendit, Albulena Haxhiu, u emërua ushtruese e detyrës së presidentit më 4 prill.

Edhe vetë Haxhiu u bëri thirrje të dielën partive për arritjen e një konsensusi për zgjedhjen e presidentit, duke theksuar se vendi nuk duhet të shkojë në zgjedhje të jashtëzakonshme.

Përpjekjet e mëparshme për presidentin e ri të vendit dështuan pasi asnjëra palë nuk u duk e gatshëm të bëjë lëshime.

Partia në pushtet në një seancë më 5 mars kishte paraqitur dy emra për president: Glauk Konjufcën, ministrin e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe deputeten Fatmire Mullhaxha-Kollçaku, por seanca s'u mbajt në mungesë kuorumi, pasi opozita e braktisi sallën.

Të nesërmen, ish-presidentja Vjosa Osmani nxori një dekret për shpërndarje të Kuvendit dhe hapje të rrugës për zgjedhje të reja. Vetë Osmani synonte edhe një mandat të dytë, mirëpo nuk e siguroi mbështetjen e nevojshme në këtë drejtim.

Dekreti u rrëzua nga Gjykata Kushtetuese pas ankesës nga qeveria.

Gjykata tha se dekreti nuk kishte asnjë efekt juridik dhe e përcaktoi 28 prillin afat të fundit për zgjedhje të presidentit.

## Kryeprokurori Çerkini mban takim me pjesëtarë të KFOR-it amerikan

FERIZAJ, 21 PRILL - Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Ferizaj, Burim Çerkini, ka pritur në takim njohës pjesëtarë të KFOR-it amerikan, togerin Jon Tolmich-komandant i LMT në Ferizaj, rreshterin Jacob Vervisch, zv/komandant i LMT, si dhe rreshterin Joshua Newsome.

Gjatë këtij takimi kryeprokurori Çerkini u uroi mirëseardhje të pranishmëve dhe i njoftoi ata me strukturën organizative, përgjegjësitë, kompetencat dhe mënyrën e funksionimit të Prokurorisë Themelore në Ferizaj.

Ai theksoi rëndësinë e bashkëpunimit dhe shprehu mirënjohje për vizitën dhe përkrahjen dhe angazhimin e vazhdueshëm të tyre.

Të pranishmit diskutuan tema me interes të përbashkët dhe shprehën gatishmëri për të forcuar dhe thelluar edhe më tej bashkëpunimin në të ardhmen.



# ORGANIZOHET "JAVA NDËRKOMBËTARE E KADETËVE 2026", DHJETËRA PJESËMARRËS NGA VENDE TË NDRYSHME



PRISHTINË, 21 PRILL - Qendra për Studime Universitare (QSU) edhe këtë vit organizoi aktivitetin "Java Ndërkombëtare e Kadetëve", i cili u mbajt për herë të tretë me radhë. Në këtë aktivitet morën pjesë dhjetëra pjesëmarrës, duke përfshirë stafin drejtues dhe kadetë nga akademi të ndryshme, si ShBA, Kanadaja, Turqia, Italia dhe Shqipëria. Duke bashkuar kadetë nga vende të ndryshme, kjo javë krijon mundësi për shkëmbim përvojash dhe kulturash si dhe për ndërtimin e lidhjeve të qëndrueshme profesionale. Ajo kontribuon në rritjen e besimit dhe në thellimin e partneriteteve ndërmjet shteteve.

Në përputhje me praktikat e akademive ndërkombëtare, kjo iniciativë ndihmon në forcimin e mirëkuptimit dhe bashkëpunimit afatgjatë.

Në kuadër të synimeve të KOMFSK gjenerallejtënant Jashari, për promovimin dhe ndërkombëtarizimin e QSU-së në arenën ndërkombëtare të akademive ushtarake, nga një numër i kufizuar aktivitetesh ndërkombëtare vjetore që kishte më herët, QSU tashmë brenda një viti akademik realizon dhjetëra aktivitete ndërkombëtare. Ky zhvillim nuk përfaqëson vetëm rritje të numrit të aktiviteteve, por edhe përmirësim të dukshëm në cilësinë, përmbajtjen dhe shtrirjen e bashkëpunimit ndërkombëtar. Këto aktivitete përfshijnë programe të ndryshme shkëmbimi të stafit, kadetëve dhe programeve akademike.

Të gjitha këto aktivitete promovojnë Qendrën për Studime Universitare dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës si partner i besueshëm në shërbim të paqes dhe stabilitetit.

# KOSOVA I SHPREH MIRËNJOHJE AJOVËS PËR AVANCIMIN E KAPACITETEVE TË FSK-së

PRISHTINË, 21 PRILL - Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Bashkim Jashari, ka pritur në një vizitë zyrtare Agjutantin e Përgjithshëm të Gardës Kombëtare të Ajovës, gjeneralmajor Stephen Osborn. Vizita u zhvillua në frymën e partneritetit të qëndrueshëm dhe bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Gardës Kombëtare të Ajovës, duke reflektuar marrëdhëniet e shkëlqyera ndërmjet Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Gardës Kombëtare të Ajovës të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Me këtë rast, gjenerallejtënant Jashari i uroi mirëseardhje të ngrohtë gjeneralit Osborn dhe delegacionit shoqërues, duke shprehur mirënjohjen për mbështetjen e vazhdueshme që Garda Kombëtare e Ajovës ka dhënë për zhvillimin dhe avancimin e kapaciteteve të FSK-së.

Gjatë takimit të dy gjeneralët zhvilluan bisedime për thellimin e mëtejmë të bashkëpunimit dypalësh, me theks të veçantë në planifikimin dhe realizimin e aktiviteteve të përbashkëta, trajnimeve dhe shkëmbimit të përvojave profesionale.

Në përmbyllje të takimit të dy palët riafirmuan përkushtimin për forcimin e mëtejmë të marrëdhënieve dhe zgjerimin e bashkëpunimit në fusha me interes të përbashkët, në funksion të rritjes së kapaciteteve dhe përmbushjes së misionit të FSK-së.



# IKD PUBLIKON RAPORTIN PËR DREJTËSINË CIVILE: LËNDËT NË KOSOVË ZVARRITEN DERI NË NJË DEKADË



PRISHTINË, 21 PRILL - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), me përkrahje të National Endowment for Democracy (NED) dhe European Endowment for Democracy (EED), në një konferencë për medie ka publikuar të martën raportin "Drejtësia Civile në Kosovë 2025".

Raporti u paraqit nga hulumtuesi i lartë i IKD-së, Gzim Shala dhe monitoruesja Blendina Veliqi.

Ky raport paraqet trendët kryesorë të trajtimit të rasteve civile nga gjykatat në Kosovë gjatë vitit 2025. Në fokus të tij janë barazia e trajtimit të rasteve, ngarkesa e gjykatave, efikasiteti i gjyqtarëve, mbajtja e seancave, kohëzgjatja e procedurave, trajtimi i rasteve pronësore, përdorimi i ndërmjetësimit, shpërndarja e gjyqtarëve dhe ndikimi i tarifave gjyqësore në qasjen në drejtësi.

Gjetjet e këtij raporti tregojnë se përderisa disa raste të iniciuara gjatë vitit 2025 janë përfunduar brenda po atij viti, ka raste të cilat kanë marrë epilog vetëm pas më shumë se një (1) dekade. Një situatë e tillë ngre dyshime për trajtim të pabarabartë të palëve në rastet civile.

## 180 tabela digjitale për shkollat në kryeqytet

PRISHTINË, 21 PRILL - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka bërë me dije se janë shpërndarë 180 tabela digitale për shkollat në kryeqytet. Ai ka thënë se tashmë edhe shkolla "Hasan Prishtina" është digjitalizuar, duke e bërë mësimin më interaktiv dhe më efikas. "Përveç tabelave digjitale, po integrojmë edhe inteligjencën artificiale për ta lehtësuar punën e mësimdhënësve dhe për ta bërë procesin e mësimnxënies më të avancuar për nxënësit", ka shkruar Rama në "Facebook".



# VRASJA E LIRIDONA ADEMAJT: MURSELI E PLAVA DËNOHEN ME BURGIM TË PËRJETSHËM, KOKALLA ME 30 VJET



PRISHTINË, 21 PRILL - Gjykata Themelore në Prishtinë i ka dënuar të martën me burgim të përjetshëm Naim Murselin dhe Granit Plavën, ndërsa Kushtrim Kokallën me 30 vjet burgim për vrasjen e Liridona Ademajt më 29 nëntor të vitit 2023.
Në fjalët përfundimtare në gjyqin ndaj tyre, Prokuroria ka kërkuar burgim të përjetshëm për ta, duke pretenduar se vrasja e 30-vjeçares, bashkëshorte e Murselit, ishte kryer në mënyrë të planifikuar.
Duke kundërshtuar akuzat e Prokurorisë, avokatët e të akuzuarve thanë se nuk ka prova të drejtpërdrejta se Murseli, Plava dhe Kokalla kanë kryer veprat penale.
Vëllai i Ademajt ka kërkuar burgim të përjetshëm për Murselin, Kokallën dhe Plavën, duke thënë se vrasja ishte e organizuar nga të akuzuarit dhe e ka lënë familjen në dhimbje të madhe.

### Çfarë thanë para gjyqit Naim Murseli dhe të tjerët?

Në të dy deklarimet për akuzat që e ngarkojnë, Murseli ka mohuar fajësinë për vrasjen e Ademajt, duke thënë se nuk ka paguar, porositur apo ndihmuar në vrasjen e bashkëshortes së tij. Ai pretendon se natën kritike familja ishte përballur me një grabitje dhe se ai nuk ka qenë në veturë në momentin e vrasjes, duke e quajtur çdo akuzë ndaj tij si të pavërtetë.
Ndërsa Plava nuk ka pranuar të deklarohet rreth fajësisë, por gjatë dëshmisë së tij ai ka thënë se veprimet i kishte bërë sipas marrëveshjes me Murselin, që ky vetëm ta merrte përgjegjësinë për rastin. Ai pretendon se në momentin kritik vetëm dëgjoi krismën e më pas iu tha të largohej nga vendi i ngjarjes, bashkë me armën që ishte kryer vrasja, duke pohuar se më pas kishte ikur me shpejtësi.
Kurse Kokalla, që fillimisht s'kishte pranuar të deklarohej, më vonë gjatë shqyrtimit ishte deklaruar i pafajshëm për rastin. Gjatë dëshmisë së tij ai ka mohuar përfshirjen në krim, duke theksuar se për ngjarjen kishte mësuar fillimisht nga mediet.

### Si dyshohet se ndodhi vrasja?

Mbrëmjen e 29 nëntorit të 2023-s Liridona Ademaj u vra në një rrugë në fshatin Bërnicë të Prishtinës teksa ishte në veturë bashkë me bashkëshortin Naim Murseli dhe dy fëmijët e tyre.
Aktakuza e ngarkon Murselin se kishte planifikuar vrasjen e saj, me qëllim që të përfitonte nga sigurimi i saj jetësor në Suedi në vlerë prej rreth 260 mijë eurosh.
Kokalla akuzohet se e kishte njoftuar Murselin me Plavën, i cili akuzohet se ishte dorasi.
Plava akuzohet se kishte vrarë Ademajn me armë zjarri, duke e qëlluar në kokë, sipas ekspertit mjekoligjor, në një largësi prej 2 deri në 5 centimetra. Sipas Prokurorisë, ai kishte kryer vrasjen në këmbim të 30 mijë eurove nga Murseli.
Mirëpo, gjatë gjyqit, Kokalla ka deklaruar se marrëveshja me Murselin, për ta marrë përgjegjësinë e vrasjes, ishte për 250 mijë euro, por që të mos përmendeshin shuma të mëdha ishin dakorduar që në Polici të përmendeshin vetëm 30 mijë euro.
Ndërkaq, prokurorja e rastit, Javorka Përlinçeviq, ka deklaruar gjatë shqyrtimit gjyqësor se Murseli e kishte mbajtur për krahu bashkëshorten e tij, që të mos i shpëtonte plumbit. "...Naimi, në mënyrë dinake, me dorën e tij të djathtë, e ka mbajtur Liridonën për krahun e dorës së saj të majtë, me qëllim që ajo të mos i shmangej plumbit, pas çka, Naimi, me fëmijët, ka dalë nga vetura, dhe është larguar nga vendi i ngjarjes", ka thënë prokurorja në nisje të procesit gjyqësor, më 31 janar 2025.
Pistoletën, me të cilën ishte kryer vrasja, Murseli akuzohet se e kishte blerë nga Tom Dodaj për 280 euro, në ditën e ngjarjes tragjike.
Ky i fundit ka pranuar fajësinë në fillim të procesit gjyqësor, ndërsa në shkurt të 2025-s u dënua me pesë vjet burgim dhe pesë mijë euro gjobë për veprën penale "Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse".
Mirëpo, pas rreth një viti, Gjykata e Apelit ia uli dënimin Dodajt në tre vjet burgim dhe 3 mijë euro gjobë, duke përmendur si faktorë pranimin e fajësisë, kërkimfaljen ndaj familjes së viktimës, dhe faktin që "nuk kishte qenë në dijeni se për çfarë do të përdorej arma që kishte shitur".

### Reagimet për krimin

Vrasja e Ademajt nxiti reagim publik, sidomos kur u ngritën dyshimet se ishte porositur nga bashkëshorti i saj, i cili mori pjesë në ceremoninë e varrimit të saj.
Familja, më pas, kërkoi zhvarrosjen e trupit të saj, për ta rivarrosur në varrezat e familjes Ademaj.
Pak ditë pas vrasjes në Prishtinë u mbajt marsh protestues, teksa protestë në numër më të vogël të njerëzve u zhvillua edhe në kryeqytetin e Shqipërisë, Tiranë.
Rreth 60 gra janë vrarë në Kosovë që nga viti 2010 - në të shumtën e rasteve, autorë të vrasjeve kanë qenë bashkëshortët, pastaj baballarët dhe djemtë.
Më 12 prill 2024, Erona Cokli, 21-vjeçare, u vra nga bashkëshorti i saj në Qendrën për Punë Sociale në Ferizaj. Katër ditë më vonë, më 16 prill, po nga bashkëshorti u vra edhe 43-vjeçarja Gjyljeta Ukella në Pejë. Më 21 janar 2026 një grua tjetër u vra – dorasi i krimit në Dragash dyshohet të jetë i biri i saj.

## Shefja në detyrë e BE-së takon Kurtin, i paraqet gjetjet e Misionit të Zgjedhjeve



PRISHTINË, 21 PRILL - Kryeministri Albin Kurti ka pritur në takim shefen në detyrë të Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Eva Palatova. Në takim, Palatova i dorëzoi kryeministrit Kurti raportin përfundimtar të Misionit të Ekspertëve Zgjedhorë të BE-së mbi zgjedhjet e fundit lokale dhe parlamentare.
Të dy diskutuan rreth procesit zgjedhor të 28 dhjetorit, i cili dëshmoi edhe një herë se Kosova organizon zgjedhje të lira, të drejta dhe sipas standardeve evropiane.
Kryeministri Kurti vlerësoi angazhimin e misionit dhe theksoi gatishmërinë e qeverisë për t'i zbatuar rekomandimet.
Kurti theksoi nevojën për qasje proaktive ndaj dezinformimit dhe ndërhyrjeve të huaja në informacion. "Lajmet e rreme, sondazhet e fabrikuara, deklaratat e paverifikuara dhe materialet e manipuluara vizualisht, ishin format më të shpeshta të dezinformimit, me potencial për të ndikuar perceptimin publik dhe besimin në procesin zgjedhor. Zgjedhjet e lira dhe të ndershme janë thelbi i Grupit të Parë të Kapitujve të negociatave të BE-së dhe kritereve politike të Kopenhagës. Me zgjedhje të lira dhe të ndershme, Kosova ka përmbushur këto kritere në mënyrë të vazhdueshme dhe të verifikueshme. Andaj, kryeministri Kurti kërkoi që gjetjet pozitive të Misionit Vëzhgues të pasqyrohen qartë edhe në Raportin e Vendit të Komisionit Evropian për vitin 2026", ka njoftuar Qeveria e Kosovës.

## Shahini: FMN godet fort, Kosova edhe në 2030-n ndër vendet më të varfra në Evropë



PRISHTINË, 21 PRILL - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) ka reaguar me shqetësim të thellë lidhur me parashikimet e fundit të Fondit Monetar Ndërkombëtar, sipas të cilave, Kosova edhe në vitin 2030 do të vazhdojë të jetë një nga vendet me të ardhurat më të ulëta për frymë në Evropë.
Kryetari i AKB-së, Agim Shahini, ka vlerësuar se këto parashikime janë shumë serioze për ekonominë e vendit dhe tregojnë se rritja ekonomike nuk po përkthehet në mirëqenie reale për qytetarët. "Ekonomia vazhdon të mbetet e varur nga konsumi dhe remitencat, ndërsa investimet produktive dhe mbështetja për bizneset vendore mbeten të pamjaftueshme. AKB kërkon nga institucionet e vendit ,ndryshim urgjent të politikave ekonomike ,rritje të investimeve kapitale, mbështetje reale për prodhimin vendor dhe eksportin, dhe përmirësim të klimës së investimeve", ka theksuar Shahini.
Ai ka theksuar se parashikimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar janë një pasqyrë serioze e realitetit ekonomik në Kosova. "Pa reforma të thella dhe mbështetje të fuqishme për sektorin privat, vendi rrezikon të mbetet në fund të Evropës edhe në vitin 2030. Është koha për veprim të guximshëm dhe ndryshim të kursit ekonomik për bizneset dhe investitorët e Kosovës", ka deklaruar Agim Shahini, kryetar i AKB-së.

# ZRRE SIGURON KONSUMATORËT: DO TË PARANDALOHEN DËMET NË FATURIMIN E RRYMËS



PRISHTINË, 21 PRILL - Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka njoftuar të martën se në vazhdimësi është duke monitoruar situatën lidhur me shqetësimet e paraqitura nga konsumatorët për devijimin e mundshëm të orëve tarifore në faturimin e energjisë elektrike.
"ZRRE siguron të gjithë konsumatorët se, në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë akterët relevantë, do të ndërmerren veprime konkrete me qëllim që të parandalohet çdo dëm i mundshëm ndaj konsumatorëve dhe të garantohet një proces i drejtë dhe transparent i matjes së energjisë elektrike. ZRRE informon publikun se në rastet e paraqitura nga konsumatorët lidhur me devijimin e mundshëm të orëve tarifore në faturimin e energjisë elektrike, ka ndërmarr të gjitha veprimet e saja konform legjislacionit në fuqi, duke kërkuar zëvendësimin e atyre njehsorëve elektrik, si dhe marrjen e masave konkrete për korrigjimin financiar në përputhje me vlerësimet e teknike", ka njoftuar ZRRE-ja.
Sipas ZRRE-së, është e rëndësishme të theksohet se në shumicën e rasteve të dërguara për verifikim është konstatuar se matja e energjisë ka qenë e saktë, ndërsa pasaktësitë kanë qenë kryesisht të natyrës së devijimit të kohës tarifore. "Megjithatë, në pjesën më të madhe të rasteve, korrigjimet financiare nuk kanë rezultuar në favor të konsumatorëve, por pavarësisht kësaj çdo rast do të trajtohet me seriozitet. ZRRE edhe njëherë rithekson se KEDS dhe KESCO janë ndërmarrje të rregulluara dhe operojnë në përputhje me kornizën ligjore dhe rregullative në fuqi dhe se të hyrat e tyre përcaktohen nga ZRRE, gjë që e kufizon mundësinë për të përfituar nga gabimet eventuale në matjen e energjisë elektrike. Gabimet eventuale nëse ndodhin mund të kenë efekt të përkohshëm deri në identifikimin dhe korrigjimin e tyre dhe çdo konsumator i prekur do të kompensohet plotësisht, në përputhje me dispozitat ligjore dhe rregullative në fuqi. Moszbatimi i këtyre detyrimeve nga operatorët do të trajtohet sipas kornizës përkatëse ligjore", thuhet në njoftimin për medie.
ZRRE-ja ka theksuar se mbetet e përkushtuar për transparencë, përgjegjësi dhe trajtim të drejtë të çdo ankese të paraqitur nga konsumatorët në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi.

# DOGANA MERR PJESË NË AKTIVITETET PËR NDËRGJEGJËSIMIN E TË RINJVE MBI PRONËSINË INTELEKTUALE



FUSHË-KOSOVË, 20 PRILL - Dogana e Kosovës, në bashkëpunim me Agjencinë e Pronësisë Industriale dhe Zyrën për të Drejtat e Autorit, organizoi trajnim në Shkollën Profesionale "Hoxhë Kadri Prishtina" në Fushë-Kosovë në kuadër të aktiviteteve për Muajin e Pronësisë Intelektuale.
Aktiviteti me temë "Sporti & Pronësia Intelektuale" kishte për qëllim t'i informonte nxënësit rreth të drejtave të tyre si krijues dhe ta rritë vetëdijen mbi mbrojtjen e ideve, markave, inovacioneve dhe krijimeve në fushën e sportit.
Gjatë sesioneve u diskutuan procedurat e mbrojtjes ligjore, rëndësia e respektimit të të drejtave të pronësisë intelektuale dhe rreziku i produkteve të falsifikuara për tregun dhe konsumatorët.
Përfaqësuesja e Doganës së Kosovës, Sadije Topojani, në përmbyllje ka theksuar: "Këto logo nuk janë vetëm vizatime - ato janë pasuri intelektuale. Edhe një ide e thjeshtë mund të ketë vlerë të madhe".
Ky aktivitet kontribuoi në nxitjen e inovacionit dhe kreativitetit te studentët, duke i inkurajuar ata t'i ruajnë dhe zhvillojnë idetë e tyre në mënyrë të ligjshme dhe profesionale.

## Në mars 2026 u regjistrua numri më i madh i përfituesve nga skema e shtesave për fëmijë

PRISHTINË, 21 PRILL - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar statistikat e mirëqenies sociale për muajin mars 2026. Sipas të dhënave të muajit mars 2026, struktura e përfituesve nga skemat e mirëqenies sociale, kryesisht ka në fokus mbështetjen e të moshuarve, kategoritë e dala nga lufta dhe familjet në nevojë. Ndërkohë skemat e tjera përfshijnë pensionet familjare, pensionet paraplegjike dhe tetraplegjike, pensionet e familjeve të dëshmorëve dhe invalidëve të luftës, pensionet e Forcës së Sigurisë së Kosovës, pensionet e Trepçës, programi për mbështetje financiare për shtesat për fëmijë, si dhe skema të tjera specifike sociale.



# BOMBA BËRTHAMORE E ANTHROPIC: KUR INTELIGJENCA ARTIFICIALE KALON PRAGUN E KONTROLLIT



Në ditët e para të prillit 2026, ndërsa një studiues po mbyllte një analizë gjashtëmujore mbi sulmet kibernetike të mbështetura nga Inteligjenca Artificiale, një zhvillim i ri në Silicon Valley ndryshoi papritur kornizën e gjithë debatit.

Anthropic kishte prezantuar modelin e saj më të ri, Claude Mythos Preview, një sistem që sipas vlerësimeve të para nuk përfaqësonte thjesht një përmirësim teknologjik, por një ndryshim paradigme në vetë natyrën e sigurisë digjitale globale.

Brenda pak orësh, ajo që deri atë ditë cilësohej një kufi i qëndrueshëm mes kapaciteteve të shteteve dhe aktorëve individualë në fushën e sulmeve kibernetike, dukej se ishte shkrirë. Mythos, sipas analizave të brendshme të cituara në komunitetin e sigurisë, ishte i aftë të identifikonte dhe shfrytëzonte dobësi të panjohura më parë në sisteme operative dhe shfletues kryesorë, pa ndërhyrje njerëzore dhe në mënyrë autonome.

Në terma praktikë, kjo nënkuptonte që një sistem i vetëm mund të kryente në mënyrë të pavarur atë që më parë kërkonte ekipe të tëra hakerësh të sponsorizuar nga shtete.

Themeluesi i Anthropic, Dario Amodei, prej kohësh ka bërë krahasime mes Inteligjencës Artificiale dhe epokës bërthamore, duke mbajtur në zyrë librin "The Making of the Atomic Bomb" si një kujtesë të përhershme mbi pasojat e pakontrolluara të inovacioneve teknologjike. Por Mythos, sipas kritikëve dhe vetë disa studiuesve të sigurisë, nuk ishte më thjesht një metaforë. Ai përfaqësonte një zhvendosje reale në balancën e fuqisë digjitale.

Në thelb të këtij shqetësimi qëndron një ndryshim strukturor: deri dje, sulmet kibernetike ishin të kufizuara nga kapaciteti njerëzor, burimet dhe koha. Sot, me modele të këtij niveli, kufizimi nuk është më ekzistues.

Një sistem i vetëm mund të gjenerojë mijëra dobësi të shfrytëzueshme në pak ditë, duke e tejkaluar në mënyrë dramatike ritmin e mbrojtjes, i cili ende mbështetet në cikle javore ose mujore për patch-e dhe përditësime.

Kjo ka krijuar një disbalancë të re, të cilën disa analistë e përshkruajnë si "asimetria kaotike": një gjendje ku sulmuesit veprojnë në kohë reale, ndërsa mbrojtja funksionon ende me logjikën e institucioneve burokratike. Në këtë skenar, mjafton një dobësi e vetme e pashfrytëzuar për të hapur rrugën e një komprometimi masiv.

Ndërkohë, modeli i ri nuk është mbajtur i hapur për publikun e gjerë. Anthropic ka zgjedhur një qasje të kufizuar përmes një programi të quajtur "Project Glasswing", duke e vënë teknologjinë në dispozicion të një numri të vogël kompanish të mëdha për qëllime mbrojtëse. Megjithatë, edhe kjo qasje është parë me skepticizëm, pasi vetë natyra e modelit nuk ndan qartë kufirin mes sulmit dhe mbrojtjes.

Në këtë kontekst, shqetësimi kryesor nuk lidhet më vetëm me shtetet. Për herë të parë, kapacitetet e këtij niveli mund të bien edhe në duart e aktorëve jo-shtetërorë, nga grupet kriminale te individët me aftësi teknike minimale. Kjo ul ndjeshëm pragun e hyrjes në sulme komplekse dhe rrit ndjeshëm rrezikun e incidenteve të shkallës së gjerë në infrastrukturat kritike.

Paralelisht, sistemi aktual global i sigurisë kibernetike duket i papërgatitur për këtë ritëm. Proceset e zbulimit, raportimit dhe korrigjimit të dobësive janë ndërtuar mbi një supozim të vjetër: se vulnerabilitetet zbulohen ngadalë dhe në mënyrë lineare. Mythos e përmbys këtë supozim duke prodhuar një volum të tillë dobësish saqë vetë koncepti i "patch-it" rrezikon të bëhet i pavlefshëm.

Në këtë sfond, debati po zhvendoset nga pyetja nëse Inteligjenca Artificiale mund të ndihmojë mbrojtjen, drejt një pyetjeje më të ashpër: nëse infrastruktura aktuale e sigurisë është në gjendje të mbijetojë në një botë ku sulmi dhe mbrojtja nuk janë më simetrike.

Propozimet që po qarkullojnë në qarqet politike dhe akademike variojnë nga krijimi i një autoriteti të unifikuar ndërinstitucional për menaxhimin e rrezikut, deri te reformimi i plotë i sistemit të menaxhimit të vulnerabiliteteve në infrastrukturat kritike. Por edhe vetë autorët e këtyre ideve pranojnë se koha është faktori më i pamëshirshëm në ekuacion.

Në fund, historia e Mythos nuk është vetëm një histori teknologjie. Ajo është një histori për ritmin me të cilin institucionet arrijnë – ose dështojnë – të përshtaten me realitetin që krijon inovacioni.

Dhe nëse paralelizmi me epokën bërthamore qëndron, atëherë pyetja nuk është më çfarë është ndërtuar, por kush do të ketë kohë ta kuptojë para se të bëhet vonë.




# Sport




## Drita shpallet kampione dhe siguron rikthimin në Superligë




**Gjilan, 21 prill** - Drita ka arritur sukses të madh duke u shpallur kampione e Ligës së Parë të Meshkujve në ProCredit Superligë dhe ka siguruar inkuadrimin në elitën e basketbollit të Kosovës. Skuadra nga Gjilani e ka mbyllur serinë finale me dy fitore ndaj Proton Cable Prizrenit, duke triumfuar edhe në ndeshjen e dytë me rezultat të ngushtë 92:91. Ndeshja e dytë është zhvilluar në Gjilan, ku Drita si vendëse ka arritur ta ruajë epërsinë në një përballje shumë të fortë deri në sekondat e fundit. Në ndeshjen e parë finale Drita kishte fituar më bindshëm me rezultat 85:71, duke e vendosur që herët epilogun e serisë. Në këtë fitore, një nga më të dalluarit te Drita ka qenë Ardian Ibishi me tetëmbëdhjetë pikë, dymbëdhjetë kërcime dhe katër asistime. Ndërkohë, Jay Walker ka kontribuar me njëzet pikë, nëntë kërcime dhe tri asistime. Te Proton Cable Prizreni më i dalluari ka qenë Rron Dahsyla me njëzet e tri pikë, shtatë kërcime dhe nëntë asistime, ndërsa Qendrim Ajazaj ka shtuar njëzet e një pikë, dhjetë kërcime dhe katër asistime.

# SOT PËRCAKTOHEN FINALISTËT E KUPËS SË KOSOVËS

Prishtinë, 21 prill - Sot (e mërkurë) do të përcaktohen edhe dy skuadrat që do të përballen në finalen e madhe të Kupës së Kosovës në futboll. Pas ndeshjeve të para gjysmëfinale, të mërkurën nga ora 15:00 do të zhvillohen ndeshjet e kthimit që do të luhen në Ferizaj dhe Klinë. Skuadrat vendase janë në avantazh ndaj skuadrave mysafire të cilat i mposhtën në duelet e para që u zhvilluan javë më parë.




Ferizaj, që ka triumfuar 2:1 në Podujevë, tani e pret Llapin, ekip që kërkon përmbysjen dhe kualifikimin në finalen e Kupës së Kosovës. Si Ferizaj ashtu edhe Llapi janë duke luftuar për mbijetesë në Superligë, por duan triumfin në Kupë për ta siguruar daljen në garat evropiane sezonin e ardhshëm. Në krye të Ferizajt në këtë ndeshje do të debutojë edhe trajneri i rikthyer Arsim Abazi, i cili është zyrtarizuar të hënën te skuadra vendase.

Ndërkohë, Ballkani i Suharekës ka mision tejet të vështirë në ndeshjen e kthimit kundër Dukagjinit, ekip që ndeshjen e parë e fitoi me rezultat të thellë 3:0. Ballkani nuk ka treguar formë të mirë as në kampionat në xhirot e fundit, ndërsa Dukagjini në këtë përballje futet pas fitores 3:2 në udhëtim kundër Gjilanit.

# MEDIUMI TURK: MURIQI ARRIN MARRËVESHJE PERSONALE ME FENERBAHÇEN



**Stamboll, 21 prill** - Fenerbahçe ka nisur lëvizjet për sezonin e ardhshëm dhe ka arritur një marrëveshje paraprake me sulmuesin e Kosovës, Vedat Muriqi, për një rikthim të mundshëm në Stamboll. Klubi verdhë-blu, që aktualisht ka mungesë opsionesh në repartin ofensivë përveç të riut Sidiki Cherif, e sheh Muriqin si zgjedhjen ideale për ta udhëhequr sulmin në sezonin e ri. Drejtuesit kanë vepruar shpejt, duke mos pritur hapjen zyrtare të merkatos së verës.

Mediumi turk "Sabah" ka raportuar se Fenerbahce tanimë ka arritur marrëveshje personale me sulmuesin kosovar. Sulmuesi 30-vjeçar, i cili është aktualisht pjesë e Mallorcas, është i hapur për t'u rikthyer tek ish-klubi i tij, ku ka luajtur gjatë sezonit 2019-2020. Fenerbahçe pritet të nisë së shpejti negociatat me klubin spanjoll për ta finalizuar transferimin. Sipas raportimeve, Mallorca do të kërkojë rreth 10 milionë euro për kartonin e lojtarit. Muriqi po kalon një sezon të shkëlqyer në La Liga, ku ka shënuar 21 gola dhe renditet i dyti në garën për "Pichichi", pas Kylian Mbappe të Real Madridit. Me 30 paraqitje zyrtare këtë sezon, nga të cilat 29 si titullar, Muriqi mbetet një nga sulmuesit më në formë në Evropë, duke e bërë rikthimin e tij një prioritet për Fenerbahçen.

# NJË SHQIPTAR KAMPION I GJERMANISË ME BAYERNIN, ERBLIN OSMANI FUTET NË LIBRAT E HISTORISË

Munich, 21 prill - Një paraqitje mund të mjaftojë për ta fituar titullin e kampionit në futboll dhe kjo është dëshmuar nga talenti nga Kosova, Erblin Osmani, i cili në moshën 16-vjeçare është shpallur kampion i Gjermanisë me Bayern Munichun. Bayerni e ka siguruar titullin e Bundesligës për sezonin 2025/26 të dielën, katër xhiro para fundit, duke e fituar kështu trofeun e 35-të të kampionit në histori. Osmani, i lindur më 19 maj 2009 në Gjermani, është grumbulluar vetëm në një ndeshje të Bundesligës këtë edicion, por kjo ka qenë e mjaftueshme që ai të futet në listën e kampionëve. Më 21 mars, në fitoren 4-0 ndaj Union Berlinit, mesfushori është aktivizuar nga minuta e 87, duke e zëvendësuar Leon Goretzkan. Ky debutim e ka futur Osmanin edhe në librat e historisë si një




prej lojtarëve që e kanë fituar titullin me Bayernin, ndërsa klubi shihet se ka besim në të ardhmen e tij. Ai mund të ketë më shumë minuta në ndeshjet e mbetura në Bundesligë. 16-vjeçari ka kontratë me gjigantin bavarez deri në verën e vitit 2027, por pritet që së shpejti të diskutohet edhe një marrëveshje e re. Në nivel të akademisë, Osmani është duke shkëlqyer me ekipin U17 të Bayernit ku këtë sezon ka regjistruar 16 paraqitje, 6 gola dhe 7 asistime, ndërsa ka edhe dy ndeshje me ekipin U19, shifra që e konfirmojnë progresin e tij të shpejtë. Bayerni e ka përfshirë Osmanin edhe në posterin e lojtarëve që e kanë fituar titullin këtë sezon, ku ai bën pjesë në mesin e një grupi të futbollistëve që kanë ardhur nga sistemi i të rinjve dhe kanë shijuar për herë të parë futbollin profesionist. Pas sigurimit të kampionatit, Bayerni synon tani edhe trofetë e tjerë: Kupën e Gjermanisë dhe Ligën e Kampionëve.

## Të rinjtë e Real Madridit fitojnë Ligën e Kampionëve



**Madrid, 21 prill** - Real Madridi ka fituar të paktën një trofe këtë sezon dhe është shpallur sërish kampion i Evropës. Real Madridi ka fituar finalen e UEFA Youth League, që në thelb është Liga e Kampionëve për ekipet nën 19 vjeç pasi ka mposhtur Club Bruggen në penallti, pas barazimit 1-1 në një mbrëmje me diell në Zvicër. Portieri i Madridit, Javier Navarro, ishte vendimtar në fitoren 4-2 me penallti, duke pritur goditjet e Naim Amengai dhe Tian Koren. Ky është titulli i dytë i gjigantit spanjoll në historinë 12-vjeçare të këtij kompeticioni evropian për të rinj, dhe vjen vetëm pak ditë pas eliminimit në çerekfinalet e Ligës së Kampionëve, ku Madridi nuk kishte asnjë lojtar të dalë nga akademia në formacionin titullar kundër Bayern Munichut. Presidenti i klubit, Florentino Perez, ishte i pranishëm në stadiumin e klubit zviceran Lausanne-Sport, së bashku me presidentin e UEFA-s, Aleksander Ceferin.

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

ZKA
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 5, 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 01/2024 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare (ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (ZKA) Nr. 05/2026), lidhur me nenin 29.3 Rregullores (ZKA) 03/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës; Punës (ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (ZKA) Nr. 03/2025), Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2026 si dhe Vendimit të Auditores së Përgjithshme me Nr.559 për plotësimin e vendit të lirë të punës, Zyra Kombëtare e Auditimit shpall:

**KONKURS**
**për plotësimin e vendit të lirë të punës**

1. **Pozita:** **Auditor junior për auditim të performancës**
   **Numri i referencës:** AJAP/ZKA/05-04/26
   **Grada:** ZKA-Z4
   **Numri i pozitave:** Një (1)
   **Kohëzgjatja e emërimit:** Me kohë të pacaktuar

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Kryen auditime sipas planit vjetor, rregullave dhe metodologjisë së ZKA-së, Kodit të Etikës dhe në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe raporton Drejtorit të Departamentit të Auditimit dhe udhëheqësit të ekipit të auditimit;
- Kryen hulumtime dhe analizë për fushën të caktuar dhe bën propozimin e temave audituese për planifikimin strategjik dhe atë vjetor të ZKA-së;(nën mbikëqyrje nga UA);
- Pjesëmarrje aktive në parastudim të auditimit në fusha të caktuara dhe deleguara nga UE;
- Ofron përkrahje profesionale duke kryer hulumtime dhe analiza te të dhënave të mbledhura dhe prezantimin e tyre;
- Mbajtja e shënimeve dhe dokumentimi i intervistimit dhe gjetjeve tjera;
- Nxjerrja konkluzioneve dhe dhënia e rekomandimeve duke u mbështetur në dëshmitë auditues dhe në bazë të gjykimit profesional;
- Përgatitja e Letrave të punës me kohë së bashku me dëshmitë përkatëse dhe memo përmbledhës lidhur me auditimin e komponentës, fushës apo pyetjeve auditues, e cila i është caktuar;
- Indeksimi i letrave të punës dhe diskutimi me Udhëheqësin e tij/saj;
- Raportimi i vazhdueshëm te mbikëqyrësi lidhur me progresin e arritur në auditim;
- Aplikimi i punës online sipas kërkesave dhe udhëzimeve në nivel të zyrës për situata të caktuara;
- Kryen edhe detyra të tjera profesionale të kërkuara nga UEA dhe nga Drejtori i departamentit.

Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, në auditimet e performancës janë:

- Arsimimi: Diplomë fakulteti në ekonomi, juridik, administratë publike, shkenca politike, shëndetësi, komunikimit ose inxhinierisë;
- Përvoja profesionale: Dy (2) vite përvojë pune profesionale në hulumtim, analiza, financa ose auditim;
- Preferohet njohuri e gjuhës angleze.

**Shkathtësitë e kërkuara**:

- Njohuri në fushën e auditimeve;
- Shkathtësi në organizim të punës dhe përmbushje të objektivave;
- Njohuri të akteve juridike të aplikueshme në Zyrën Kombëtare të Auditimit;
- Njohuri për mbikëqyrje efektive të punës profesionale;
- Aftësi për të përfaqësuar dhe mbrojtur interesat e institucionit dhe integritetin e tij;
- Aftësi motivuese, dhe komunikuese në ekip;
- Të posedoj aftësi të mira ndër-personale.

**Informata të përgjithshme për kandidatë:**
Përcaktimi i pagës bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**<u>Procedura e Aplikimit:</u>**
Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

**Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:**

- formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- dëshmitë për përgatitjen arsimore (Diplomë fakulteti). Diplomat e fituara jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara;
- dëshmitë për përvojën e punës (Kontratë Pune ose Vërtetim i Marrëdhënies së punës, të shoqëruara me dëshmi nga Trusti);
- dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- dëshmia që nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik (*nëse aplikohet*);

Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysh. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen. Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (*online*) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data **07.05.2026 ora 16.00.**

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën www.zka-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin për administrimin e dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

**Shënim:**
Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

ZKA
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

U prilog članu 15.2 Zakona Br. 05/L-055 za Generalnog Revizora i Nacionalnu Kancelariju Revizije Republike Kosovo, kao i članova 5, 6 i 7 Uredbe (NKR) 01/2024 o Prijemu i Karijeri u Nacionalnoj Kancelariji Revizije (izmenjena i dopunjena Uredbom (NKR) Br. 05/2026), u vezi sa čl. 29.3 Uredbe (NKR) 03/2024 o Klasifikaciji Radnih Mesta; (izmenjena i dopunjena Uredbom (NKR) Br. 03/2025), Godišnjeg Plana Zapošljavanja za 2026. godinu kao i Odluku Generalne Revizorke pod Nr.559 za popunjavanje upražnjenog radnog mesta, Nacionalna Kancelarija Revizije objavljuje:

**KONKURS**
**za popunu slobodnog radnog mesta**

1. **Pozicija:** **Junior Revizor za reviziju učinka**
   **Referentni broj:** AJAP/NKR/05-04/26
   **Rang:** NKR-Z4
   **Broj pozicija:** Jedna (1)
   **Trajanje imenovanja:** Na neograničeno vreme

**Dužnosti i odgovornosti:**

- Vrši revizije u skladu sa godišnjim planom, pravilima i metodologijom NKR, Etičkim kodeksom i u skladu sa Međunarodnim standardima revizije i izveštava Direktora Sektora za reviziju i vođu revizorskog tima;
- Vrši istraživanje i analizu za zadatu oblast i predlaže teme revizije za strateško i godišnje planiranje NKR (pod nadzorom VR);
- Aktivno učešće u pred-studijama revizije u određenim oblastima delegirane od strane VT;
- Pruža stručnu podršku kroz istraživanje i analizu prikupljenih podataka i njihovu prezentaciju;
- Vođenje beleški i dokumentovanje intervjua i drugih nalaza;
- Donošenje zaključaka i davanje preporuka na osnovu revizorskih dokaza i na osnovu profesionalnog prosuđivanja;
- Blagovremena priprema Radnih papira zajedno sa relevantnim dokazima i rezimeom memoranduma koji se odnosi na reviziju komponente, oblasti ili pitanja revizije koja su mu dodeljena;
- Indeksiranje radnih papira i razgovor sa njegovim/njenim menadžerom;
- Kontinuirano izveštavanje nadzornika o napretku postignutom u reviziji;
- Primenjivanje onlajn rada prema zahtevima i uputstvima na nivou kancelarije za određene situacije;
- Obavlja i druge profesionalne poslove koje zahteva VTR i Direktor Odeljenja

Opšti formalni uslovi za ovo radno mesto, u reviziji učinka, su:
- Obrazovanje: Diploma fakulteta ekonomije, prava, javne administracije, političkih nauka, zdravstva, komunikacija ili inženjeringa.
- Profesionalno iskustvo: Dve (2) godine profesionalnog radnog iskustva u istraživanju, analizi, finansijama i reviziji;
- Poželjno je poznavanje engleskog jezika.

**Potrebne veštine:**

- Istaknuto znanje iz oblasti revizije;
- Veština u organizovanju rada i ispunjavanju ciljeva;
- Poznavanje pravnih akata koji se primenjuju u Nacionalnoj Kancelariji Revizije;
- Poznavanje efektivnog nadzora nad stručnim radom;
- Sposobnost zastupanja i zaštite interesa institucije i njenog integriteta;
- Motivacione i komunikacione veštine u timu;
- Poseduje dobre međuljudske veštine.

**Opšte informacije za kandidate**:
Određivanje plate vrši se u skladu sa važećim zakonima.

**<u>Postupak prijave</u>**:
Postupak prijave je otvoren za sve kandidate koji ispunjavaju kriterijume konkursa. Nacionalna Kancelarija Revizije nudi jednake mogućnosti zapošljavanja svim građanima Kosova i kandidatima iz svih zajednica na Kosovu.

**Kandidati trebaju dostaviti potrebnu dokumentaciju, i to:**

- službeni obrazac NKR za prijavu;
- kopiju lične karte Republike Kosovo;
- dokaz o školskoj spremi (Fakultetska diploma). Diplome stečene van Kosova moraju biti nostrifikovane;
- dokaz o radnom iskustvu (Ugovor o radu ili Potvrda o radnom odnosu, uz dokaz iz Trusta);
- potvrda iz suda da nije pravosnažno osuđivan (ne starije od šest meseci);
- dokaz da ne postoji disciplinska mera za razrešenje sa javne funkcije (ako se primenjuje);

U obzir će se uzeti samo zvanični obrazac za prijavu. Dokumenti dostavljeni nakon roka neće se razmatrati, a nepotpuni će biti odbijeni. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume. Konkurs je otvoren 15 dana od dana objavljivanja u elektronskim medijima (*online*) i na internet stranici Nacionalne Kancelarije Revizije. Zadnji rok za predaju dokumentacije je dana **07.05.2026, u 16.00 časova.**

Obrasci za prijavu mogu se dobiti na recepciji NKR-a, ili se mogu preuzeti sa web stranice NKR-a na adresi www.zka-rks.org i predati Odeljenju za administraciju dokumenata na adresi: Naselje: Arberia, ul. "Ahmet Krasniqi" br. 210 – Priština, svakog radnog dana od 08:00 – 16:00 časova, obrazac i prateća dokumentacija se mogu dostaviti i putem imejla na adresu rekrutimi@oagks.org ili putem pošte. Za detaljnije informacije možete nas kontaktirati na tel. 038/606-004, lokal 1025.

**Napomena:**
Prijave poslate poštom, koje nose poštanski pečat o pošiljci poslatoj poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se važećim i biće razmatrane.

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

ZKA
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 5, 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 01/2024 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit Kombëtare (ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (ZKA) Nr. 05/2026), lidhur me nenin 29.2 të Rregullores (ZKA) 03/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës (ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (ZKA) Nr. 03/2025), Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2026 si dhe Vendimit të Auditores së Përgjithshme me Nr.559 për plotësimin e vendit të lirë të punës, Zyra Kombëtare e Auditimit shpall:

## KONKURS
## për plotësimin e vendit të lirë të punës

1. **Pozita:** **Auditor junior për auditim financiar dhe pajtueshmëri**
   **Numri i referencës:** AJAFP/ZKA/06-04/26
   **Grada:** ZKA-Z4
   **Numri i pozitave:** Një (1)
   **Kohëzgjatja e emërimit:** Me kohë të pacaktuar

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**
- Ndihmon UE në mbledhjen e informatave paraprake për auditimet ku angazhohet, për përgatitjen e dosjeve të auditimit dhe punë tjera në lidhje me auditimin;
- Shkrimi i letrave të punës së auditimit të qarta për çështjet e trajtuara dhe sipas standardeve të ZKA-së dhe të njëjtat i dorëzon me kohë të UE;
